



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2022:282527

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05734172

C.nr.324/2023

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, përmes me gjyqtarin Artan Abazi, me bashkëpunëtorin profesional Blerand Sopi, duke vendosur lidhur me çështjen kontestimore të paditësve S.G. nga, F.K. nga dhe Z.A. nga, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës Kosovës - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, në Prishtinë, me objekt kontesti kthimin në vendin e punës dhe kompensimit të ardhurave personale, jashtë seancës gjyqësore, më datën 24.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Procedura në këtë çështje kontestimore **NDËRPRITET** për shkak të çështjes paraprake, respektivisht deri sa të përfundojë me vendim të formës së prerë, procedura penale ndaj të pandehurve, tani paditësve S. G. nga, F. K. nga dhe Z.A. nga

II. Procedura e ndërprerë do të vazhdojë pasi që të krijohen kushtet ligjore, me kërkesën e palëve ndërgjyqëse apo kur të njëjtit i thërret gjykata.

A r s y e t i m

Paditësit me datë 28.12.2022, kanë parashtruar në këtë gjykatë padi kundër të paditurës, për anulimin kthimin në vendin e punës dhe kompensimit të ardhurave personale.

Gjykata, përmes administratës së kësaj gjykate, me datë 14.05.2024 është njoftuar se kundër paditësve S. G., F. K. dhe Z. A. me të dhënat e lartëcekura, është duke u zhvilluar procedurë penale sipas aktakuzës PP.II.nr.1462/2020 të datës 05.11.2021, e cila është inicuar në Gjykatën Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë, e cila evidentohet me numrin P.nr.205/2021, dhe kjo çështje penale ende nuk ka përfunduar me vendim të plotëfuqishëm.

Meqenëse, paditësit kanë paraqitur padi me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i të paditurës lidhur me ndërprerjen e mardhënies së punës, ndërsa e paditura ndërprerjen e

mardhënies së punës e ka bërë bazuar në dyshimin se paditësit kanë kryer vepër penale, gjykata duke i pasur parasysh faktet dhe provat e lartcekura, gjykata vendosi që në këtë çështje kontestimore ta ndërpret procedurën, derisa çështja penale e lartcekur të merr epilog, përkatësisht e njëjta të përfundohet me vendim të plotfuqishëm të Gjykatës.

Andaj, duke marrë parasysh të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform nenit 14 dhe 278 paragrafi 2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË KAMENICË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.324/2023 më datë 24.05.2024

G j y q t a r i
Artan Abazi, d. v

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, pas marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.